



NEON A.S  
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005  
TIRANA, ALBANIA  
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770  
E-MAIL: [info@neon.al](mailto:info@neon.al) WEB: [www.neon.al](http://www.neon.al)

## NEON ANTIRUST PROFFESIONAL (BOJË ANTINDRYSHK PROFESIONALE)

Skedë Teknike

**PËRSHKRIMI:** NEON ANTIRUST PROFFESIONAL është një suspension bojatisës profesional me cilësi të lartë me bazë rezinë alkide, me destinacion lysterjen e konstruksioneve metalike për tu mbrojtur nga ndryshku dhe për dekoracion. Referuar përbërësve të saj, ka vetinë që të frenojë procesin e oksidimit (ndryshkjes) të sipërfaqeve metalike, në mjedise të brendëshme dhe të jashtme.

**FUSHA E PËRDORIMIT:** NEON ANTIRUST PROFFESIONAL përdoret për dozën e parë të lysterjes së sipërfaqeve metalike, në mjedise të brendëshme dhe të jashtme, për mbrojtjen nga ndryshku të këtyre sipërfaqeve.

**NGJYRA:** E zezë, e bardhë, kafe, gri, ngjyrë tulle etj

**PARAPËRGATITJA:** Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës apo të ndryshkut, të lidhura dobët me sipërfaqet.

**PËRDORIMI:** Përgatitet boja duke e holluar fillimisht me diluent NC – 10.00 ose NX – 20. 000 ose White Spirit “NEON” NW – 13.30 në sasi 10 % ÷ 20 %, për të përfutur një bojë të gatshme e cila të punohet relativisht lehtë me penel, rrul ose pistoletë dhe të mos rrjedhë në sipërfaqet vertikale.

**KUJDES:** Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe dhe të pa pastruara paraprakisht. Gjatë aplikimit të përdoren doreza të përshtatshme pune për të evituar kontaktin e bojës me lëkurën, si dhe në rastin e përdorimit të pistoletës duhet përdorur maskë mbrojtëse për organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me sytë, duhet bërë shpërlarja e tyre me ujë të bollshëm dhe të kërkohet ndihmë mjeksore. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lysterjes paisjet duhet të lahen menjëherë me white spirit.

### TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....Sipas katalogut
- Imtësia.....5 – 40 µm
- Viskoziteti Deep Cup 4.....200 – 300 sek
- Densiteti.....0.94 – 1.35 g/ml
- Fuqia mbuluese për lysterje të plotë.....10 – 12 m<sup>2</sup>/L
- Koha e tharjes.....2 – 4 orë

**REZIKSHMËRIA:** Bojrat ANTIRUST janë të djekshme (R10), të dëmshme po të nuhaten (R20), irritojnë lëkurën (R38) si dhe duhet të ruhen larg fëmijëve (S 2), në vënde të ajrosura mirë (S 9) dhe larg burimeve të zjarrit (S 16). Po kështu, mbeturinat e bojës nuk duhen derdhur në kanalet e shkarkimit (S 29) dhe ambalazhet e përdorura duhen hedhur në vënde të sigurta (S 35).

**AMBALAZHIMI:** Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 0.75L.